

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Statistikat e Mirëqenies Sociale, Nëntor 2025

19.12.2025

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) publikon Statistikat e Mirëqenies Sociale për muajin nëntor 2025.

Bie numri i përfituesve të pensioneve Invalidore të punës në nëntor 2025, krahasuar me nëntor 2024

Numri i përfituesve nga skemat pensionale dhe skemat e tjera të mirëqenies sociale

	Muaji/Viti		11/2025
	21/11/2024	21/11/2025	11/2024
Skema e ndihmës sociale	18,226	16,269	-10.7
Pensionet bazike të moshës	154,167	165,611	7.4
Pensionet kontributpaguese të moshës	48,333	47,480	-1.8
Pensionet e personave me aftësi të kufizuara	20,810	21,647	4.0
Pensionet e Trepçës	1,135	910	-19.8
Pensionet e Forcave të Sigurisë së Kosovës	859	928	8.0
Pensionet e Trupave Mbrojtëse të Kosovës	1,371	1,384	0.9
Skema e të verbërve	1,841	1,853	0.7
Pensionet Familjare	2,842	2,533	-10.9
Pensionet e Invalidëve të punës	41	29	-29.3
Pensionet Paraplegjike dhe Tetraplegjike	3,046	3,441	13.0
Skema e kompensimit për punëtorët e arsimit për vitet 90/91 deri në 98/99	14,292	15,004	5.0
Pensionet e familjeve të dëshmorëve dhe invalidëve të luftës	12,681	12,504	-1.4
Veteranët	36,976	37,065	0.2
Skema për përkrahje financiare familjeve që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara	3,610	4,064	12.6

Rënie e përfituesve nga skemat e pensioneve, krahasuar me një vit më parë

Në muajin nëntor 2025, krahasuar me muajin nëntor 2024, kishte rënie të numrit të përfituesve nga: skema për pensionet invalidore (-29,3%); skema për pensionet e Trepçës (-19,8%); skema për pensionet familjare (-10,9%); skema e ndihmës sociale (-10,7%); skema e pensioneve kontribut-paguesve të moshës (-1,8%); skema për familjet e dëshmorëve dhe invalidët e luftës (-1,4%).

Rritje e përfituesve nga skemat e pensioneve, krahasuar me një vit më parë

Në muajin nëntor 2025, krahasuar me muajin nëntor 2024 kishte rritje të numrit të përfituesve nga: skema për Pensionet Paraplegjike dhe Tetraplegjike (13.0%); skema për përkrahje financiare familjeve që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara (12,6); skema e pensioneve të Forcës së Sigurisë së Kosovës (8,0%); skema e pensioneve bazike të moshës (7,4%); skema e kompensimit për punëtorët e arsimit që punuan gjatë vitit shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99 (5,0%); skema e pensioneve për personat me aftësi të kufizuara (4,0%); skema e pensioneve të Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK) (0,9%); skema e kompensimeve për personat e verbër (0,7%); skema për veteranët e luftës (0,2%).

Për më shumë informata lidhur me Statistikat e Mirëqenies Sociale për muajin Nëntor 2025, vizitoni:
<https://ask.rks-gov.net/Themes/SocialWelfare>